REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

Tiranë, më 1.11.2021

RAPORT
(Komision përgjegjës)

PËR

AKTIN NORMATIV

NR. 30, DATË 27.09.2021

"PËR MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE TË NËNSHKRUARA NË MARRËVESHJEN PËR PRODHIMIN DHE FURNIZIMIN, NGA DHE NDËRMJET PFIZER EXPORT B.V. DHE MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE TË SHQIPËRISË, MINISTRIT TË SHTETIT PËR RINDËRTIMIN DHE INSTITUTIT TË SHËNDETIT PUBLIK, MIRATUAR ME AKTIN NORMATIV NR.3, DATË 18.1.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE"

■ Hyrje

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e Komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 1.11.2021, mori në shqyrtim Aktin Normativ nr. 30, datë 27.09.2021 "Për miratimin e disa ndryshimeve të nënshkruara në marrëveshjen për prodhimin dhe furnizimin, nga dhe ndërmjet Pfizer Export b.v. dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, Ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik, miratuar me aktin normativ nr.3, datë 18.1.2021, të Këshillit të Ministrave".

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut caktoi relator për shqyrtimin e këtij projektligji deputetin Toni Gogu.

Në mbledhjet e Komisionit për të mbrojtur projektligjin dhe për të dhënë shpjegime për pyetjet e anëtarëve të Komisionit ishin të pranishëm dhe Znj. Eugena Tomini, Zv. Minsitre e Shendetesise dhe Mbrojtjes Sociale.

I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Akti normativ i propozuar për miratim, është akt normativ me fuqinë e ligjit, në bazë të nenit 101 të Kushtetutës, i cili përcakton se Këshilli i Ministrave, në rast nevoje dhe urgjence, nën përgjegjësinë e tij, mund të nxjerrë akte normative që kanë fuqinë e ligjit.

Akti normativ shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

II. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE PËRMBAJTJA E TIJ

Me qëllim parandalimin e infektimit me Sars-Cov-2, qeveria shqiptare ka bërë përpjekjet maksimale për sigurimin e vaksinave Anticovid, si me anë të mekanizmit Covax ashtu dhe me anë të marrëveshjeve bilaterale, ku një ndër to është edhe marrëveshja me kompaninë Pfizer Export B.V.

Shqipëria i ka hapur rrugë përdorimit në popullatë të kësaj vaksine, bazuar në aktin normativ nr.1, datë 10.1.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e tekstit të marrëveshjes, për prodhimin dhe furnizimin, nga dhe ndërmjet Pfizer Export BV, dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, Institutit të Shëndetit Publik, dhe Ministrit të Shtetit për Rindërtimin, autorizimin e procedurës për lejimin e hyrjes dhe administrimit të vaksinave Anti-Covid-19 në Republikën e Shqipërisë, si dhe përdorimin e tyre në popullatë", të ndryshuar.

Përdorimi në popullatë i vaksinës Pfizer-Biontech Covid-19 Vaccine është aprovuar edhe nga Komiteti i Ekspertëve të Imunizimit në mbledhjen e zhvilluar në datën 21 dhjetor 2020. Është aprovuar, gjithashtu, në mbledhjen e datë 23 dhjetor 2020 nga Komiteti Kombëtar i Imunizimit dhe nga Komiteti i përkohshëm për infeksionin e përhapur nga Coronavirusi i ri në datë 24.12.2020.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, bazuar në Strategjinë Kombëtare të vaksinimit anti-Covid, planifikon të sigurojë vaksinimin e popullatës target si dhe të garantojë mbulimin me dozat e vaksinave anti-Covid bazuar në rekomandimet e Komiteteve të Imunizimit.

Instituti i Shëndetit Publik ka kërkuar që të sigurohen sipas skenarëve të parashikuar rreth 4,4 milionë doza të vaksinave anti-Covid për vaksinimit të plotë të popullatës target.

Aktualisht, është arritur furnizimi i dozave të vaksinës bazuar në kontratat dhe marrëveshjet e lidhura si dhe donacioneve të mbërritura nga partnerët dhe vendet anëtare të BE.

Në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është ngritur grupi i punës me anë të urdhrit të ministrit, nr.2, datë 5.1.2021, "Për ngritjen e grupit të punës për vlerësimin e kushteve të kontratës së Marrëveshjes "Për prodhimin dhe furnizimin ndërmjet Pfizer Export B.V dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutin e Shëndetit Publik", me specialistë të fushave të ndryshme, i cili negocioi marrëveshjen bazë të miratuar nga Pfizer Export B.V dhe po ky grup ndoqi procesin e amendimit të kësaj marrëveshjeje të propozuar nga Pfizer Export B.V për të siguruar doza të tjera të kësaj vaksine.

Në këtë kontekst, ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe përfaqësuesve të Pfizer Export B.V. janë zhvilluar bisedime për furnizimin e mëtejshëm me vaksinën e prodhuar nga kjo kompani.

Gjatë bisedimeve, u dakordësua nga kompania Pfizer Export B.V amendimi i kontratës fillestare, duke shtuar sasinë e dozave pasi kjo do të ishte në favor të shtetit shqiptar për arsye se çmimi nuk do të ndryshonte dhe kushtet e lëvrimit gjithashtu. Sa më sipër u dakordësua amendimi i marrëveshjes fillestare.

Kompania propozoi të sillnin sasinë brenda dhjetorit 2021 por iu kërkua që procesi të përshpejtohej dhe të realizohej në një kohë më të shpejtë për shkak të urgjencës që paraqet rritja e mbulimit me vaksina për popullatën.

Amendimet në marrëveshje prekin dhe pjesë të tjera si shtimin e përkufizimit të juridiksionit shqiptar, ndryshimin e termit vaksinë, ndryshimin e parashikimeve në rast mungese furnizimi, zgjerimin e hapave të procedurës në rast të një produkti jofunksional dhe parashikime lidhur me rishitjen apo dhurimin.

Marrëveshja është konfidenciale dhe kjo ka qenë një nga kushtet e panegociueshme me kompaninë Pfizer Export B.V. Detyrimi per ruajtjen e konfidencialitet, pra mospublikimin e marrëveshjes për shkak të sekretit tregtar është rregulluar në aktin normativ nr.1, datë 10.1.2021, dhe është në fuqi edhe për tekstin e marrëveshjes së firmosur.

Teksti i kësaj marrëveshjeje është miratuar me anë të aktit normativ nr.29, datë 13.9.2021.

Marrëveshja është nënshkruar përfundimitsht nga palët më datë 23.09.2021.

III. VLERËSIMI I KUSHTETUTESHMËRISË SË AKTIT NORMATIV

Neni 101 i Kushtetutës ka parashikuar të drejtën e Këshillit të Ministrave për të nxjerrë akte rregullatore me fuqinë e ligjit. Kjo e drejtë ka natyrë lejuese dhe përjashtimore, prandaj Kushtetuta e ka kushtëzuar ushtrimin e saj me ekzistencën e nevojës dhe urgjencës si rrethana dhe situata fakti që vlerësohen rast pas rasti, si dhe me kontrollin përfundimtar nga Kuvendi të akteve të nxjerra.

Sipas dispozitave kushtetuese, akti normativ me fuqinë e ligjit, në mungesë të kohës së nevojshme për të filluar një procedurë normale të miratimit të një propozimi për të ndryshuar ligjin, është një instrument që mundëson përshpejtimin e procedurave për nxjerrjen e ligjit.

Ky akt normativ propozohet në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës. Në këtë dispozitë kushtetuese parashikohet që Këshilli i Ministrave ka të drejtën e nxjerrjes së këtyre akteve normative me fuqinë e ligjit.

Pandemia aktuale e shkaktuar nga Sars-Cov-2 (Covid-19) ka shkaktuar dëme të mëdha në shëndetin e njerëzve, duke kaluar deri në humbjen e jetës dhe dëme ekonomike qoftë për buxhetin e personave të prekur, qoftë për buxhetin e bizneseve për shkak të vendosjes së masave kufizuese të frekuentimit të tyre, ashtu si dhe dëme në buxhetin e shtetit, duke kaluar fokusin më të madh në investimet në shërbimet shëndetësore, kryesisht spitalore.

Situata e krijuar nga Sars-Cov-2 vlerësohet e pamundur të presë aq kohë sa nevojitet për nxjerrjen e ligjit të nevojshëm nga organi ligjvënës, qoftë edhe nëpërmjet procedurave të përshpejtuara.

Nevoja për një vaksinë kundër Sars-Cov-2 është imediate për rivendosjen e ekuilibrit normal social dhe ekonomik.

Akti normativ nr. 30, plotëson të gjitha kriteret e analizuara nga Gjykata Kushtetuese në vendimet e saj, veçanërisht vendimet nr.24, datë 10.11.2006; nr.23, datë 16.4.2014 etj. Konkretisht, për miratimin e një akti normativ kërkohet të plotësohen kushtet që vijojnë :

a) Nevoja dhe urgjenca si kushte për nxjerrjen e aktit normativ me fuqinë e ligjit

b) Përkohshmëria e masave që përmban akti normativ me fuqinë e ligjit

c) Fuqia ligjore e këtyre akteve dhe kufizimet për nxjerrjen e tyre

ç) Miratimi i aktit normativ me fuqinë e ligjit nga Kuvendi

1. Nevoja dhe urgjenca si kushte për nxjerrjen e aktit normativ me fuqinë e ligjit:

Neni 101 ka parashikuar nevojën e urgjencën si rrethana dhe situata fakti që vlerësohen rast pas rasti. Situata me të cilën vazhdon të përballet vendi ynë si rezultat i pandemisë të shkaktuar nga COVID-19.

2. Përkohshmëria

Akti normativ vepron me fuqinë e ligjit për një periudhë kohe, maksimalisht 45-ditore. Përkohshmëria e këtij akti normativ lidhet me kushtin e domosdoshmërisë së shqyrtimit të tij nga Kuvendi, i cili, nëse e miraton, e kthen atë në ligj.

Akti Normativ që po shqyrtojmë vlerësohet se është një akt që del pikërisht në kushtet e nevojës dhe të urgjencës dhe i plotëson të gjitha kriteret e analizuara nga Gjykata Kushtetutese në vendimet e saj, veçanërisht vendimi nr.24 datë 10.11.2006, vendimi nr.23 datë 16.4.2014, etj.

IV. ÇËSHTJE TË DISKUTUARA NË KOMISION

Gjatë shqyrtimit të projektligjit në Komision nga relatori u vlerësua ndërmarrja e kësaj nisme ligjore për të ofruar nje menaxhim te situates se shkaktuar nga infeksioni si me anë të mekanizmit Covax ashtu dhe me anë të marrëveshjeve bilaterale, ku një ndër to është edhe marrëveshja me kompaninë Pfizer Export B.V.

Deputeti relator Z. Gogu theksoi se nevoja për amendimin e marrëveshjes fillestare buron nga e drejta e shtetasve për tu vaksinuar, ndërsa urgjenca lidhet me pamundësinë që në kohën e mbetur në dispozicion, masat e propozuara nëpërmjet këtij akti normativ për të shtuar sasinë e dozave nuk mund të zgjidhen nëpërmjet procesit të rregullt legjislativ nga Kuvendi.

Gjithashtu deputeti relator Z. Gogu theksoi se amendimi i kontratës fillestare, duke shtuar sasinë e dozave është në favor të shtetit shqiptar për arsye se çmimi nuk do të ndryshonte dhe kushtet e lëvrimit gjithashtu.

Gjatë diskutimit, Komisioni mbështeti qendrimin e relatorit dhe e vlerësoi projektligjin shumë të rëndësishëm.

V. PËRFUNDIM

Në përfundim të shqyrtimit të këtij projektligji, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, pasi vlerësoi se:

Në aspektin ligjor, vlerësoj se projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në përfundim, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e Komisionit përgjegjës, votoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi dhe me shumicën e votave, e miratoi atë dhe u shpreh dakord për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare.

RELATOR	**KRYETARI**
TONI GOGU	**KLOTILDA BUSHKA**